



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:021628

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05468102

**C.nr.101/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen kontestimore të paditëses Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Mbrojtjes Mjedisit dhe Pyjeve, kundër të paditurit V. K Z nga Fsh M. K-M, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 212.00 euro, pas kthimit të padis në plotësim, jashtë seancës gjyqësore me datë 18.03.2024 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

Padia e paditëses Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Mbrojtjes Mjedisit dhe Pyjeve e parashtruar në këtë gjykatë me dt. 24.01.2023, kundër të paditurit V.K. Z nga Fsh M, K-M, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 212.00 euro, HEDHET POSHTË.

**A r s y e t i m**

Paditësja Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Mbrojtjes Mjedisit dhe Pyjeve Korporata, ka parashtruar padi kundër të paditurit V.K. Z nga Fsh M, K-M, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 212.00.

Gjykata Themelore në Mitrovicë e ka nxjerr aktvendim për përgjigje në padi, mirëpo nga flet kthesa e dt.13.05.2023 është konstatuar se “pala është i pa njohur me këto të dhëna”,.

Gjykata në lidhje me situatën e krijuar, me aktvendimin C.nr.101/2023 të dt. 06.07.2023 e ka kthyer padinë në plotësim, që në afat prej 3 ditësh, kësaj Gjykate t’i siguroj adresën e sakët të debitorit, e nëse nuk veprohet sipas udhëzimeve në aktvendim, gjykata padinë do ta konsideroj se është tërhequr, po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se e kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë.

Paditësja më datë 07.08.2023, e ka pranuar konkluzionin në fjalë, dhe me dt. 10.08.2023 e ka njoftuar gjykatën se nuk kanë adresë tjetër përpos asaj të dhënë si në padi, andaj nga te lartcekurat gjykata konsideron se paditësja nuk e ka korrigjuar –plotësuar padinë, mbi këtë rrethanë e hedhi poshtë padinë.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit konform nenit 99 e në lidhje me nenin 102 par.3 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.101/2023, me datë 18.03.2024**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.